



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

BORDI

RREGULLORE

**MBI
FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE RREGULLAT PËR MBAJTJEN E REGJISTRAVE
TË NDËRMJETËSVE NË SIGURIME**

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 40, datë 31.03.2016

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton formën, përmbajtjen dhe rregullat për mbajtjen e regjistrave të personave fizikë dhe juridikë që janë licencuar nga Autoriteti, për të kryer veprimtari ndërmjetësimi në sigurime.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 219 të Ligjit 52/2014 datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3

Mbajtja e Regjistrave

1. Regjistrat e përcaktuar në nenin 1 të kësaj rregulloreje mbahen në formë elektronike.
2. Regjistrat janë të hapur për publikun në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
3. Regjistrat bëhen publik nëpërmjet faqes së internetit të Autoritetit, në adresën www.amf.gov.al.

4. Regjistrat me të dhënat e plota, sipas kësaj rregulloreje, mbahen pranë Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve.
5. Regjistrat mbahen në format microsoft excel.

Neni 4

Subjektet e Regjistrave

Autoriteti mban regjistra për:

1. Shoqëritë e agjentëve të licencuara;
2. Agjentët e miratuar;
3. Shoqëritë e brokerimit të licencuara;
4. Brokerat e licencuar;
5. Dega e shoqërisë së huaj të ndërmjetësimit;
6. Bankat dhe/ose degët e bankave të huaja të licencuar për veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime;
7. Subjektet financiare jo banka;
8. Subjekte të tjera tregtare që kryejnë veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime.

Neni 5

Përmbajtja e Regjistrave

1. Regjistri i shoqërive përmban:
 - a. Emrin tregtar të shoqërisë dhe formën e shkurtuar të emrit (nëse ka);
 - b. Forma ligjore e organizimit të shoqërisë;
 - c. Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT);
 - d. Adresën e shoqërisë (Qyteti, Rruga, Kutia Postare);
 - e. Datën dhe nr. e licencës për kryerjen e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime;
 - f. Klasat e sigurimit, në të cilat është licencuar për të kryer veprimtarinë e ndërmjetësimit;
 - g. Emrin dhe mbiemrin e Administratorit;
 - h. Emrin dhe mbiemrin e Anëtarëve të Këshillit Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës;
 - i. Emrin dhe mbiemrin e Aksionarëve influencues;
 - j. Emrin dhe mbiemrin e personit/personave, i licencuar nga Autoriteti për të kryer veprimtari ndërmjetësimi;
 - k. Kontaktet e shoqërisë (e-mail , telefon , faks);

1. Kapitali i regjistruar.
2. Informacioni i përmendur në paragrafin 1), pikat (a), (b), (d), (e), (f), (g), (j) dhe (k) të këtij neni do të bëhet publik në përputhje me nenin 3, të kësaj Rregulloreje.
3. Regjistri i bankave dhe/ose degët e bankave të huaja, si dhe subjekteve financiare jo banka të licencuar për të kryer ndërmjetësim në sigurime dhe risigurime përmban:
 - a. Emrin e Bankës dhe/ose degës së bankave të huaja, subjektit financiar jo bankë;
 - b. Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT);
 - c. Adresën e selisë qendrore (Qyteti, Rruga, Kutia Postare);
 - d. Datën e miratimit të lejes dhënë nga Banka e Shqipërisë, për ushtrim veprimtarie ndërmjetësimi në sigurime;
 - e. Datën dhe nr. e licencës për kryerjen e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime;
 - f. Klasat e sigurimit, në të cilat është licencuar për të kryer veprimtarinë e ndërmjetësimit;
 - g. Emrin dhe mbiemrin e administratorit;
 - h. Emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të Këshillit Administrimit/Këshillit Mbikëqyrës;
 - i. Emrin dhe mbiemrin e aksionarëve influencues;
 - j. Emrin dhe mbiemrin e personit/personave, i licencuar nga Autoriteti për të kryer veprimtari ndërmjetësimi.
4. Informacioni i përmendur në paragrafin 3), pikat (a), (c), (e), (f), (g), (h) dhe (j) të këtij neni do të bëhet publik në përputhje me nenin 3, të kësaj Rregulloreje.
5. Regjistri i personave fizikë (agjentë dhe broker të licencuar) përmban:
 - a. Emrin dhe mbiemrin e personit fizik të licencuar;
 - b. Atësinë;
 - c. Datëlindjen;
 - d. Arsimimin;
 - e. Datën dhe nr. e licencës për kryerjen e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime;
 - f. Klasat e sigurimit, në të cilat është licencuar për të kryer veprimtarinë e ndërmjetësimit;
 - g. Shoqërinë në emër dhe përllogari të të cilës vepron;
 - h. Adresën ku kryhet veprimtaria.

6. Informacioni i përmendur në paragrafin 5), pikat (a), (e), (f), (g) dhe (h) të këtij neni do të bëhet publik në përputhje me nenin 3, të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Mënyra e regjistrimit

1. Regjistrimi i të dhënave në regjistër kryhet në mënyrë të tillë që të ruhet kronologjia e datës dhe përmbajtjes së informacioneve më të hershme, krahas informacionit të përditësuar.
2. Regjistrimi i të dhënave në regjistër bëhet brenda 5 ditëve pune nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit, apo paraqitjes së informacionit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Të gjitha subjektet, të cilave u ka përfunduar licenca mbahen në një regjistër të veçantë.

Neni 7

Dispozita të fundit

1. Të dhënat e subjekteve të regjistruara më parë, pasqyrohen në regjistrat përkatës brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.
2. Regjistrimi i subjekteve në regjistrin përkatës sipas kësaj rregulloreje do të vijojë duke ruajtur numrin rendor të mëparshëm.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.